



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendimet për ndikim të paligjshëm të dëshmitarëve, Gjykatësi i Vetëm, më 8 korrik, nxori urdhër të ri mbi zhvillimin e mëtejshëm të gjykimit.

Pas pranimit të dëshmisë si ekspert të dëshmitarit 8, në vijim të një vendimi të mëparshëm të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësi urdhëroi Mbrojtjen të njoftonte Gjykatën deri më 15 korrik 2026, nëse synonte të paraqiste prova shtesë në përgjigje ndaj dëshmisë së dëshmitarit 8.

Në qoftë se Mbrojtja nuk do të paraqesë prova shtesë, Gjykatësi i Vetëm informoi se synon të mbyllë fazën e paraqitjes së provave më 16 korrik 2026 dhe të ftojë palët të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare deri më 22 korrik dhe dosjet e kundërpërgjigjeve deri më 5 gusht 2026.

Më 2 korrik, Kryetarja e DHSK-së caktoi Panelin e Dhomës së Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me kërkesën referuese që do të dorëzohet nga Pjetër Shala. Më 3 korrik, Paneli miratoi pjesërisht kërkesën e z. Shala për zgjatjen e afatit për dorëzimin e kërkesës referuese dhe urdhëroi që kërkesa të dorëzohet deri më 15 shtator 2026. Kërkesa referuese lidhet me urdhrin për zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjykues I për viktimat e krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor në korrik 2024.

Për rikujtesë: Trupi Gjykues konstatoi se Prokurori i Specializuar kishte vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se z. Shala kishte kryer krimet e luftës së ndalimit arbitrar dhe torturës kundër të ndaluarve në një vend në veri të Shqipërisë në 1999 dhe se kishte marrë pjesë në vrasjen e një të ndaluar.

Çështja lidhet me krime të kryera në fabrikën e metalit në Kukës, që përdorej nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Viktimat, që ishin kryesisht shqiptarë, u arrestuan dhe u ndaluan me akuzën se ishin "tradhtarë" ose "bashkëpunëtorë".

Ata u mbajtën në mënyrë të paligjshme në dhoma të kyçura, në kushte poshtëruese dhe abuzuese. Provat treguan se viktimat e ndaluara në mënyrë të paligjshme u torturuan rëndë fizikisht, u keqtrajtuat psikologjikisht, u mbajtën në kushte ndalimi poshtëruese dhe pësuan lëndime fizike dhe trauma afatgjata.

Të ndaluarit u keqtrajtuat fizikisht dhe psikologjikisht nga anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, përfshirë z. Shala. Gjatë marrjes në pyetje, anëtarë të UÇK-së i rrahën të ndaluarit me shkopinj gome dhe shkopinj bejsbolli në gjithë trupin. I shkelmuan, i gjuajtën me grushte, i prenë me thika, i dogjën me cigare dhe u hodhën kripë në





plagë. Disa prej të ndaluarave u qëlluan edhe me armë zjarri. Keqtrajtimi i la me mavijosje, të mbuluar me gjak, të pamundur të qëndronin në këmbë ose të pavetëdijshëm.

Trupi Gjykses e shpalli fajtor z. Shala për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme si krime lufte dhe e dënoi me 18 vjet burgim. Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Shala në 13 vjet burgim.

Dhomat e Specializuara vijojnë këtë javë me publikimin e serisë së videove “Vështrim mbi Mandatin dhe Punën e Dhomave të Specializuara”, ku trajtohen drejtpërdrejt pyetjet e bëra me shpesh.

Temat dhe pyetjet e trajtuara në dhjetë videot e publikuara deri tani përfshijnë:

- Fjalën hyrëse nga Kryetarja e DHSK-së
- Përgjigjen për pyetjen “Pse nuk trajton DHSK-ja çdo krim”
- Paraburgimin dhe lirin me kusht, përfshirë informacion për rastet kur është miratuar lirimi me kusht
- Standardet e gjykimit të drejtë dhe të drejtat e të akuzuarve
- Vizitat humanitare
- Mbikëqyrjen dhe llogaridhënien
- Transparencën
- Provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve
- Përgjegjësinë penale individuale

Videoja më e fundit, e publikuar dje, tregon se si garantohet pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi i gjykatësve të DHSK-së, ndër të tjera, përmes procesit të përzgjedhjes dhe Kodit të Etikës Gjyqësore.

Këto video mund të gjenden në faqen e internetit në shqipe, serbishte ose anglishte përmes një dritareje në krye të faqes kryesore të DHSK-së, si dhe mund të shihen në kanalet e Gjykatës në *YouTube*, *X*, ose *Instagram*.

